



Buletin Informativ

Shkurt 2018

SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

NË KËTË NUMËR

Forumi i biznesit Hungari-Shqipëri

Nga Flutura Xhabija

Më 27 shkurt 2018, u mbajt në Budapest Forumi i Biznesit Hungari-Shqipëri. Ky aktivitet u organizua nga SHGPAZ me ndihmën e ambasadës shqiptare në Budapest/ Hungari dhe të Dhomës së Tregtisë së Tiranës. Forumi ishte i suksesshëm, efektiv dhe shpresojmë të



ketë vazhdimësi.

Sipas axhendës u realizuan disa takime si: takimi në Dhomën e Tregtisë së Budapestit, me zv.presidentin e dhomës, gratë

afariste dhe ambasadorin e Shqipërisë në Hungari, zotin Arjan Spase. Pas fjalës së mbajtur nga Ambasadori, përfaqësuesit e Dhomës Hungareze dhe DHTI Tiranë, kryetares së SHGPAZ-së, gratë sipërmarrëse të dy shteteve bashkëbiseduan për një bashkëpunim në të ardhmen.



**Konkursi IDEA per plane biznesi
15 janar deri 15 mars 2018**

A keni një ide të mirë biznesi apo një biznes të ri? Aplikoni! Faqe 2



Kosova 10 vjet pavarësi

Më 17 shkurt 2018, Kosova festoi 10 vjetorin e pavarësisë. I urojmë suksese në forcimin e konsolidimin e mëtejshëm të shtetit të Kosovës!



Forum dhe b2b me biznesin italian

Më 19 shkurt 2018 u mbajt në Tiranë Forumi i biznesit Shqiptaro-Italian. Ky aktivitet u organizua nga dy ministritë respektive të ekonomisë italiane dhe shqiptare, me pjesëmarrjen e mbi 200 sipërmarrësve të dy vendeve dhe përveç pjesës plenare, në seancat e pasditeve pati ballafaqime direkt me bizneset e interesuara. Sipërmarrës nga të gjitha krahinat e Italisë, u prezantuan me katalogun e detajuar të profileve të tyre. Shqipëria në vitet e fundit ka hedhur hapa në drejtimin e duhur.

Por, reforma madhore, si ato që prekin drejtësinë, formalizimin e ekonomisë, derregullimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit, ngritjen e një tregu të mirëfilltë energjetik, etj. janë prioriete që duhet të avancojnë më shumë gjatë këtij mandati qeverisës. SHGPAZ u përfaqësua me disa



anëtare sipërmarrëse, por nga pala italiane sipërmarrëset femra ishte shumë pak.



Konkursi IDEA për plane biznesi 15 janar deri 15 mars 2018



Konkursi **IDEA** për plane biznesi është i hapur tashmë dhe ata që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes prej më pak se 3 vjet janë të ftuar të aplikojnë. Konkursi IDEA ofron një paketë të plotë mbështetjeje nëpërmjet seancave tërheqëse të trajnimit, coaching/këshillim, mentorim dhe fituesve do t'u ofrohet grant. Linku i IDEA në facebook:

www.facebook.com/ideaalbania

Afati i aplikimit deri në datën **15 Mars 2018**.

Aplikoni në linkun:

<https://form.jotformeu.com/CEFEInternati.../aplikime-idea-2018>


Bankat dhe biznesi

Kredia start up 1.8% e totalit

Kreditimi i bizneseve gjatë vitit 2017 është rritur me 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36.5% të PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2016. Ndërsa kredia për **start up përbën vetëm 1.8%** të totalit të kredisë për bizneset dhe kjo tregon për ngurtësinë/ hezitimin e bankave për të përkrahur këtë segment. Ky segment kryesisht mbështetet nga insitucionet financiare të mikrokredisë, por që përsëri është në vlera të ulta dhe nuk mbulon nevojat e bizneseve të reja për të filluar një biznes apo për t'u zgjeruar.

Kreditimi i bankave për SME-të është i një rëndësie të veçantë, sepse ai i jep mundësi këtyre bizneseve të sigurojnë kapitalin financiar të nevojshëm për t'u rritur dhe për të qenë konkurrent në treg. Prandaj gjerësisht është pranuar se aksesit në financë është një dimension i rëndësishëm i zhvillimit të SME-ve. Një nga problematikat kryesore të SME-ve në Shqipëri, të identifikuar edhe nga disa institucione ndërkombëtare, është aksesit në financë dhe krijimi i një marrëdhënie më të fortë bashkëpunuese me bankat. Për pasojë, ky dimension përbën edhe një nga fushat/ elementët ku përqendrohet edhe një nga rekomandimet kryesore, i cili thekson rëndësinë e përmirësimit të aksesit në financë të SME-ve nëpërmjet politikave dhe nismave

shtetërore. Në fund të vitit që lamë pas, kreditë për SME-të ishin rreth 42% e portofolit të kredive që bankat kanë financuar bizneset, me rritje me 2 pikë përqindje nga një vit më parë, ose rreth 10 pikë përqindje në dy vitet e fundit. Në raport me prodhimin e brendshëm bruto kjo kredi përfaqëson 8.7%, nivel ky shumë më i ulët se sa kontributi prej 66% (INSTAT 2016), që SME-të japin në aktivitetin ekonomik në vend. Edhe pse financimi i SME-ve nga bankat ka ardhur në përmirësim në vitet e fundit, ai mbetet në nivele modeste, duke nënvizuar rëndësinë e politikave më pro aktive të autoriteteve shtetërore në mbështetjen dhe rritjen e aksesit në financë të SME-ve. Niveli ulët i financimit të SME-ve nga bankat lidhet ngushtësisht edhe me problemet që bizneset kanë me ofrimin e kolateralit, mungesën e një marrëdhënie afatgjatë/ të konsoliduar me bankat, si dhe raportimeve kontabël të certifikuar zyrtarisht të aktivitetit ekonomik të biznesit të tyre. Krahas faktorëve të sipërpërmendur ajo është e lidhur edhe me mungesën e skemave të ndarjes së rrezikut me institucionet e tjera financiare, menaxhimit eficient të rrezikut si dhe informalitetin e lartë që karakterizon këtë segment të ekonomisë. Në këtë kuadër, nismat e marra nga qeveria për formalizimin e këtij segmenti do të lehtësojë marrëdhënien e



bankave me këtë segment të bizneseve.

Marrëdhëniet e biznesit me bankat janë në tërësi komplekse sepse janë marrëdhënie besimi, bashkëpunimi dhe kërkohet një harmonizim në gjetjen e një balance, duke u kushtëzuar dhe nga problemet strukturore në tërësi të ekonomisë. Në rastin e Shqipërisë kjo marrëdhënie është akoma më e vështirë e ndikuar si nga rrethanat, kufizimet strukturore dhe zhvillimore të vet biznesit, të informalitetit të ekonomisë, por dhe strukturën financiare në vend. Pyetjes edhe sa kohë duhet të presim që SME-të të jenë një klient qendror i bankave në Shqipëri- nuk di ti përgjigjem- por një gjë është e sigurt që ky ka qenë segmenti më dinamik ku bankat po eksplorojnë mbas krizës së vitit 2011, dhe vlerësohet nga shumë prej tyre si një tokë e pashkelur, me potencial zhvillimi. Por ecja e shpejtë e trenit në të këtë segment do të varet ndjeshëm nga lloji i karburantit dhe shinat që vet autoritetet shtetërore do të shtrojnë. Me qëllim që treni e vagonët e tij të ecin përpara dhe të mbështesin rritjen e përgjithshme të ekonomisë së vendit.

Njoftim i Tatimeve:

Biznese, dorëzoni deri në fund të marsit 2018 deklaratën e pagesës së tatim fitimit dhe pasqyrat financiare për vitin fiskal 2017

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u kujton bizneseve detyrimin për dorëzimin brenda datës **30 mars** të deklaratës së pagesës së tatimit fitimit dhe pasqyrave financiare për vitin fiskal 2017.

Tatimpaguesi duhet të dorëzojë, formularin e Deklarimit të Tatimit mbi Fitimin sipas modelit të miratuar me udhëzim. Ky formular plotësohet në përputhje me shënimet sqaruese dhe dorëzohet vetëm elektronikisht



në administratën tatimore, bilancin kontabël së bashku me pasqyrat financiare dhe anekset e tij si: -Bilanci; -Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve; - Pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parësë ose pasqyra e qarkullimit të likuiditeteve (cash-flow); -Aneksi për shpjegimet shpjeguese; - Raporti i ekspertit të autorizuar të shoqërisë (kur ky raport kërkohet në zbatim të legjislacionit). Për informacion dhe asistencë, ata që kanë detyrimin e deklarimit, mund t'i drejtohen sporteleve të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në të gjithë vendin ose të **telefonojnë në numrin pa pagesë të Qendrës së Thirrjeve 0800 00 02.**

Biznese Nxitoni!

Vizitë në biznesin e Lindita Zajmit në Tiranë



Vizitë në Atelien e sipërmarrëses nga më të parat në Tiranë, që në vitin 1990, në rrugën e Kavajës. Lindita Zajmi, ndër gratë e para që guxoi të fillonte një biznes privat, edhe pse me fëmijë shumë të vegjël dhe me ngarkesa familjare të shumta. Një biznes i ndershëm dhe me hap të sigurtë arrin të balancojë çështje private dhe ato familjare. Shembuj të tjerë suksesi kanë këtë model si të Lindës ...

Forma të reja, për adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore

Më datë 1 shkurt 2018, Qendra e barazisë gjinore, Sekretariati i Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore Tiranë organizoi takimin me temë, "Forma të reja, për adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore" :

1. Forma të reja kreative, që mund të përdorë rrjeti në punën e tij;
2. Koordinimi i punës së anëtarëve të Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me bazë Gjinore; Prioritetet e rrjetit;

Angazhimi i anëtarëve të Rrjetit kundër Dhunës me bazë Gjinore në lidhje me advokimin e ndryshimeve ligjore në përmbushje të rekomandimeve të GREVIOs si dhe një zbatim më të mirë të legjislacionit ekzistues kundër dhunës me bazë gjinore; Diskutim mbi ndryshimet ligjore kryesore si lëshimi i urdhrave të mbrojtjes për viktimat e të gjitha formave të dhunës që mbulon Konventa e Këshillit të Europës për



parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e

Stambollit), diskutim në lidhje me përmirësimin e legjislacionit penal mbi adresimin e dhunës psikologjike, seksuale, përdhunimit të grave të rritura bazuar në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrimin e përdorimit të forcës apo rezistencës, moshë minimale për të kërkuar autorizim për martesë nga i mituri dhe martesat e detyruara, format e gjymtimit gjenital të grave, sterilizimi i detyruar, etj. dhe zgjedhja nga rrjeti e prioriteteve për të advokuar. Çështje të zbatimit të legjislacionit ekzistues kundër dhunës ndaj grave; reagimin e rrjetit për çështje të dhunës kundër grave në të gjithë vendin, të identifikuar nëpërmjet punës së anëtarëve të rrjetit, medias, etj.

Sugjerime në lidhje me draft manualin e OJF-ve për monitorimin e standardeve të Komitetit CEDAW, GREVIOs dhe UPR për Shqipërinë dhe shkrimin e raporteve shadow; Ky takim u organizua në kuadrin e projektit "Ngritja e një rrjeti të organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri", zbatuar nga QNL. Projekti financohet nga Komisioni Evropian, zbatohet me mbështetjen e UN Women.



Trainim projekti ReLOaD

Gjatë dy ditëve 6-7 shkurt 2018, në Tiranë, u organizua një trajnim për shoqatat e biznesit si të bëjmë projekte: Trajnim mbi ciklin e menaxhimit të projekteve, kishte një përmbajtje të detajuar dhe te fokusuar në këto fusha:

- Analiza e bashkëpunëtorëve
- Analiza e problemeve dhe qëllimeve
- Analiza e strategjive
- Rreziqet, supozimet, indikatorët, Aktivitetet dhe rezultatet
- Buxhetimi i projektit
- Prezantim i detajuar i aplikimit për programin ReLOaD, përfshirë matricën e vlerësimit
- Si të kemi një propozim të suksesshëm

Lehtësimi i procedurave doganore për biznesin dhe dixhitalizimi i sistemit

Intervistë me Drejtorin e Procedurave Doganore, Saimir Sinani

nga Violeta Shqalsi

1. Çfarë parashikojnë ndryshimet e fundit për dixhitalizimin e sistemit dhe si lehtësohen konkretisht procedurat për biznesin?

Në kuadër të reformës për lehtësimin e shërbimeve si për qytetarët ashtu edhe për sipërmarrjen, përdorimi i sistemeve të reja elektronike dhe përmiresimi i atyre ekzistuese duke qenë një nga objektivat kryesor të administratës doganore, tashmë është edhe një detyrim i legjislacionin doganor. Për këtë është miratuar dhe një Plan i Posaçëm nga Ministri i Financave realizimi i të cilit do sjellë krahas përafrimit të legjislacionit me atë European dhe përafrimin e procedurave doganore që lidhen me lehtësitë dhe thjeshtimet. Ndryshimet e fundit për dixhitalizimin e sistemit janë të lidhura me;

- **reformën e derregullimit të ndërmarrë nga Qeveria shqiptare**
- **vënien në funksionim të nënshkrimit elektronik.**

Përparësitë që rrjedhin nga këto risi lidhen me **aplikimin dhe miratimin në rrugë elektronike (on-line)** të një sërë autorizimesh e licensash që duhet të lëshohen nga autoritetet doganore. Aktualisht operatorët ekonomikë apo përfaqësuesit e tyre mund të

aplikojnë në kohë reale (on-line) për disa nga regjimet e posaçme si dhe për procedura që lidhen me pullat e akcizës.

- **Nënshkrimi elektronik** ashtu si në rastin e aplikimit on-line është elementi kryesor i deklarimit on-line dhe që i **paraprin** procesit të gjerë dhe shumë të rëndësishëm të **"doganës PA LETRA"**. Në këtë kuadër **objekti ynë** është që:

- deri më **15 mars 2018**– fillon funksionimi i nënshkrimit elektronik
- deri më **30 qershor 2018** - do të operohet me deklarimin në rrugë elektronike edhe në rrugë shkresore.
- pas **30 qershorit 2018** vetëm me **deklarim on-line (pa letër)**

Si për aplikimet ashtu dhe për deklarimin on-line **nëpërmjet nënshkrimit elektronik synohet;**

- **Ulje** e ndjeshme e **kohës dhe kostove** për individët dhe operatorët ekonomikë
- Shfrytëzimi në një masë të gjerë të **transparencës** që mundëson përdorimi i sistemeve elektronike duke bërë të mundur **rritjen e shkallës së përgjegjëshmërisë** së punonjësve (zyrtarëve) të doganës.
- **Mbajtja** e operatorëve ekonomikë **larg sportelit** të



doganës me qëllim minimizimin e mundësive korruptive.

2. Çfarë orienton dhe synon zhdoganimi i centralizuar?

---Kemi të bëjmë me një sistem që i mundëson vendeve me territor doganor të vogël përqëndrimin e procedurave të vlerësimit doganor në një zyrë të vetme në qendër nisur nga fakti që sistemi elektronik mundëson verifikimin e deklarimit në doganë pavarësisht zyrës në të cilën është depozituar deklarata doganore.

Si funksionon praktikisht kjo skemë?

Nëpërmjet përdorimit të këtij sistemi synohet:

- **Përdorimi i saktë, unifikim dhe standartizim i metodologjisë së vlerësimit** duke shmangur dukurinë e deritanishme që lidhet me vlerësimeve të ndryshme në zyra të ndryshme doganore për mallra të njejtë.
- **Përqëndrimin e autoriteteve** në degët doganore kufitare e të brendshme në drejtim të detyrave funksionale që lidhen me **kontrollet fizike dhe mbikqyrjen e regjimeve të posaçme doganore** apo të **mallrave të akcizës** në të gjithë hapsirën ku ushtrojnë kompetencën e tyre territoriale. **(vijon f.9)**

Gruaja dhe shëndeti

Psoriasis dhe një eksperiencë familjare

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Psoriasis është një sëmundje lëkure që karakterizohet nga krijimi i elementeve inflamatorë (skuqje), të ngritura mbi sipërfaqen e lëkurës, të cilat mbulohen nga luspa për shkak të shumëzimit të qelizave epiteliale. Psoriasis ndoshta është një nga sëmundjet më të hershme të njohura nga njerëzimi dhe njëkohësisht një nga më të paqartat se nga se shkaktohet. Kjo sëmundje nuk është vetëm një problem estetik: gjendja e përhershme e inflamacionit ka pasoja në të gjithë organizmin, aq shumë sa psoriasis lidhet me shqetësime të shumta, si sëmundjet kardiovaskulare, metabolike etj. Ende nuk dihen faktorët që shkaktojnë këtë sëmundje. Por sipas hipotezave, me shumë mundësi, psoriasis shkaktohet kryesisht nga faktorët gjenetikë të cilëve u shtohen ata mjedisorë dhe anomali në sistemin imunitar, por ndonjëherë, luajnë rol edhe faktorë të tjerë, si psh. disa infeksione apo stres. Zhvillimi i sëmundjes lidhet me bashkëveprime të ndërlikuara




midis qelizave të bardha të gjakut, qelizave epiteliale të lëkurës dhe një sërë elementesh të tjera të inflamacionit që quhen ndërmjetësit (kimiokina, citokina, interleukina) etj. Nga psoriasis sëmuren njësoj, si burrat ashtu edhe gratë. Psoriasis nuk është sëmundje infektuese dhe ende nuk ka ilaç për ta shëruar plotësisht.

Si Shfaqet? Ajo mund të shfaqet në çfarëdo lloj moshe, megjithatë kurimi i psoriasis bëhet më i vështirë me kalimin e moshës. Ajo më shpesh shfaqet tek të rinjtë. Gjysma e këtyre njerëzve sëmuren nga psoriasis, para moshës 25 vjeçare. Edhe fëmijët mund të sëmuren nga psoriasis, por këto janë raste të rralla. Në botë, nga psoriasis, vuajnë rreth 25 milionë njerëz. Simptomat e psoriasis mund të manifestohen në forma të ndryshme, por dallojmë katër tipe të sëmundjes.

Psoriasis me pllaka (vulgaris) është forma më e zakonshme dhe gjëndet në 80-90% e njerëzve me psoriasis. Shfaqet për vite të tëra me pllaka të skuqura që mbulohen nga luspa me ngjyrë argjendi.

Psoriasis me pika të vogla (guttata, punctata). Karakterizohet nga elemente të



vogla dhe të shpërndara, të skuqura dhe me luspa. Një formë e rrallë e psoriasisit është edhe ajo që quhet **psoriasis pustuloz** (me fluska me lëng që duket si qelb). Mund të lokalizohen në disa pjesë të trupit si në pëllëmbë të duarve dhe shputat e këmbëve ose të shpërndara në gjithë trupin.

Shumë rrallë shfaqet edhe një formë tjetër që quhet **eritrodermia psoriatike**, e cila shfaqet me skuqje dhe rrjepje në të gjithë trupin. Sëmundja shfaqet me periudha të caktuara. Në verë ajo zhduket në rast se lëkura qëndron e ekspozuar dhe merr rreze ultraviolette. Disa medikamente të tjera shërbejnë për lehtësimin e kruajtjeve.

Nga një eksperiencë familjare mund të këshillojmë që gjatë periudhës tetor-shkurt, kur kjo sëmundje acarohet së tepërmi duhet të reduktohet në maksimum (të hiqet nga dieta) konsumi i **djathit dhe gjalp**, ndërsa të reduktohet konsumi i produkteve të tjera shtazore. Gjatë periudhës së fundit ndryshimi i dietës tek personi në fjalë, solli që sëmundja të ishte më e lehtë dhe të kalonte për një periudhë më të shkurtër.

Intervistë me Drejtorin e Procedurave Doganore Saimir Sinani (nga faqe 6)

- Minimizimin e subjektivizmit dhe mundësive korruptive në vlerësimin doganor nëpërmjet mbajtjes së operatorëve ekonomike larg sportelit të doganës.

Në funksion të skemës në fjalë janë konceptuar dhe venë në funnksionim:

- **Kanali "BLU"** i përzgjedhjes për kontroll (timer 20 min.) dhe
- **Spektori i Kontrollit Aposterior** (pas zhdoganimit) Operativ (5 ditor)

Vlen të theksohet se:

Për realizimin e kësaj skeme (sistemi) të vlersimit në qendër, nga ana e stafit teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,

është bërë një punë kolosale studimore gati 8 mujore dhe është parashikuar çdo aspekt teknik në mënyrë që skema të jetë sa më funksionale dhe t'i shërbejë më së miri qëllimit për të cilin është ndërtuar.

3. Lidhur me agjencinë doganore, ka ide ose propozim për krijimin e një agjencie të vetme, çka mund të eliminojë ose konkurrojë ato private?

Autoritetet doganore janë organe ligjzbatues dhe si të tillë janë përgjegjës për zbatimin me

përpikmëri të akteve ligjore e nënligjore.

Përsa i përket përfaqësimit në doganë, legjislacioni doganor parashikon që ky përfaqësim të mundësohet:

- në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë operatorët ekonomikë, apo
- në mënyrë të tërthortë nga persona të licensuar nga autoritetet doganore si agjentë doganorë.

Deri më tani nuk jemi në dijeni të ndonjë ideje, nisme apo propozimi që gjithsesi do të kërkonte ndryshime në legjislacionin doganor lidhur me përfaqësimin në doganë.

Buletin Informativ

Janar 2018



Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 069257242
info.shgpaz@yahoo.com

Pergatiti

Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia

Kalendari i Panaireve në Poloni Janar-Prill 2018

JANUARY	 10-11.01.2018 Fruit and Vegetable Industry Fair				
FEBRUARY	 07-09.02.2018 Advertising and Printing Fair	 22-25.02.2018 Warsaw Book Show	 27.02-01.03.2018 Packaging Technology and Materials Fair	 27.02-01.03.2018 Warsaw Gastro Show	 27.02-01.03.2018 Warsaw Wine Festival
MARCH	 02-04.03.2018 Warsaw Motorcycle Show	 21-23.03.2018 Warsaw Bus	 21-23.03.2018 International Transport Shipping and Logistics Fair	 23-25.03.2018 Green Days	 23-25.03.2018 Construction / Renovation Arrangement
APRIL	 06-08.04.2018 Animals Days	 12-14.04.2018 ICT Live - IT & Mobile Expo	 12-15.04.2018 ELECTRONICS SHOW - Central European Smart Electronics Show	 20-22.04.2018 Good Game	 20-22.04.2018 Warsaw Comic Con